



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranor - Prillogje (E/Dona) 01-03-2022			
Mbiemri i bashkisë (Municipality)	Numeri i bashkisë (Municipality No)	Gjatësia (Length)	Widhtja (Width)
01-110/05-221			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA, ME NR. 01-110/05-731, E DATËS.24.09.2021

VITI, shkurt 2022

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1, dhe 12.2 shkronja c) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Republikës Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.28/2008, nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me neni 9 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27/2008, në harmoni të plotë me dispozitat e nenit 36.2 shkronja c) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, me kërkesën e MAPL-se Nr.43-800/5 të datës 19.10.2021 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 28.02.2022, merr këtë

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN-PLOTESIMIN E RREGULLORES
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA ME NR. 01-110/05-731, E DT.24.09.2021

Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale me Nr. 01-110/05-731, të datës 24.09.2021.

Neni 2

Te rregullorja bazë, neni 10, te Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, pika 10.12, nën-pika 1, 2, 6, 7 të fshihen nga rregullorja bazë, si dhe pika 10.14 e rregullores duhet të fshihet nga rregullorja bazë.

Neni 3

Te rregullorja bazë, neni 11, pika 11.4, taksat për kullotjen e bagëtisë për 1 vit fshihet çmimorja dhe duhet të jete si në vijim:

Lloji i bagëtisë	NB/ koke	URO/ koke
Gjethat mbi 1 vjet	1	1.20
Viçat	0.45	0.54
Delet	0.18	0.22
Qengjat	0.1	0.12
Kuajt dhe gomarët	1	1.20
Dosat	0.5	0.60
Derrat	0.3	0.36
Rosat	0.014	0.02

Neni 4

Te rregullorja bazë, neni 19, pika 19.2, fshihet nga rregullorja bazë, sepse është në kundërshtim me Ligjin Nr.04/L-012 për mbrojtjen nga zjarri.

Neni 5

Te rregullorja bazë, neni 24, pika 24.3, ndryshohet e plotësohet ku duhet të jetë shuma nga 4 euro të bëhet në 5 euro.

Neni 6

Te rregullorja bazë, nenit 28 i shtohen edhe këto pika:

28.2 Tarifa e taksës administrative për leje ndërtimore, Kategoria I, një euro e pesëdhjetë cent (1,50 euro) për metër katror.

28.3 Tarifa e taksës administrative për leje rrënimi për kategorinë I dhe II në Komunën e Vitisë është unike për territorin e Komunës, pesëdhjetë cent (0,50 euro) për metër katror.

28.4 Taksa për kopje të dokumenteve të planifikimit hapësinorë është 10,00€

Neni 7

Te rregullorja bazë, neni 40, pika 10.6, duhet të formulohet dhe të jetë kështu: të gjitha subjektet të cilat nuk i përgjigjen pagesës së tarifës dhe ngarkesave komunale të paraparë me këtë rregullore, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm sipas legjislacionit përkatës për përmbarimin, si dhe te rregullorja bazë fuzionohet me një dispozitë të re, si: Shqiptimi i sanksionit kundërvajtës me gjobë bëhet në përputhje me dispozitat relevante të ligjit përkatës për kundërvajtje.

Neni 8

Pjesët tjera të rregullores bazë mbesin të pandryshuara.

Neni 9

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në Web faqen

Viti, më 28.02.2022

KUVENDI I KOMUNES SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

